




REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK



Nr. .... Prot.

Vlorë, më 13.10.2017

**Vendim**  
**Nr. 94, datë 13.10.2017**

**PËR NJË ADRESË TË POSAÇME ELEKTRONIKE PËR ADRESIMIN E ANKIMIMEVE DHE SHQETËSIMEVE TË STUDENTËVE DHE STAFIT AKADEMIK**

Në mbështetje të shkronjës **a**, pika **1** në nenin **38**, shkronjës **ç**, pika **1**, neni **98** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet **31** dhe **70** në Rregulloren e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.10.2017

**VENDOSI:**

1. Të miratojë çeljen e një adrese elektronike të posaçme për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të studentëve dhe personelit akademik në lidhje me shkeljen e standardeve akademike, procesit të mësimdhënies, etikës akademike, konfliktit të interesit apo çdo shkeljeje tjetër që çënon integritetin apo të drejtat e studentëve dhe personelit akademik.
2. Drejtoria e IT-së ngarkohet për të shqyrtuar mundësitë për realizimin teknik dhe juridik të çeljes dhe menaxhimit të kësaj adrese.
3. Drejtoria e IT-së i përcjell Rektorit në formë shkresore shqetësimet e adresuara në këtë adresë.
4. Çdo filtrim shqetësimesh nga ana e IT-së përbën shkelje ligjore dhe mbart përgjegjësi penale.
5. Rektori i përcjell shqetësimet dhe ankesat tek Dekani i njësisë kryesore për të cilën është drejtuar shqetësimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektori, Dekanët e fakulteteve, Drejtoria e IT-së.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.